



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivered	22-08-2023	3 viti god vegj.	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Priloga Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHICK	5775	2023	115



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.923/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Ardita Perçuku Shyti, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, si procesmbajtëse, sipas ankesës me numër A.nr.923/2023, të datës 06.07.2023, të parashtruar nga ankuesi [redacted], nga Malisheva, kundër organit të punësimit Komunës së Malishevës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 21.08.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.923/2020, e datës 06.07.2023, e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Anulohet** Konkursi me numër reference RN00011981, për emrin e grupit Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm-Inspektor i Tokës Bujqësore, i shpallur nga Komuna e Malishevës, më datë 29.06.2023 si dhe çdo veprim i pasuar nga kjo procedurë e pranimit.
- III. Shfuqizohet** Njoftimi i datës 07.08.2023 i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, për anulimin e Konkursit me numër reference RN00011981.
- IV. Obligohet** Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Malishevës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi, siç përcaktohet në II të dispozitivit.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

1 / 5

Ankuesi, [REDACTED], më datë 06.07.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.923/2023, e plotësuar përmes shkresës me numër protokoli 923/2023 të datës 26.07.2023, me pretendimin ankimor së Komuna e Malishevës në kundërshtim me dispozita ligjore në fuqi, ka anashkaluar listën pritëse, të datës 28.10.2022, lidhur me Konkursin e pranimit me numër reference: RN00009781, për emërtimin e grupit “Specialist i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës- Inspektor i Tokës Bujqësore”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 13.07.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Malishevës, ndërsa, kjo e fundit, me datë 24.07.2023, ka përcjell shkresat referuar çështjes në shqyrtim dhe vendosje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 5037/2023 të datës 06.07.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e letërnjoftimit të ankuesit; Njoftim me Nr.01/824 i datës 12.06.2023, për përfundimin e procedurës së konkursit Lëvizje brenda kategorisë për pozitën Inspektor i Tokës Bujqësore/Drejtoria e Inspektoriatit i lëshuar nga Udhëheqësi Personelit; Njoftim me Nr.01/1808 i datës 28.10.2022 për përfundimin e procedurës së vlerësimit dhe shpalljen e rezultateve me fitues për pozitën zyrtar për Bujqësi, në kuadër të grupit specialist i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës–pas afatit të ankesave; Diploma me Nr.226 e datës 09.10.2018 e lëshuar nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë në Universitetin Hasan Prishtina në Prishtinë ku ankuesi ka marrë titullin Master i Shkencave në Ekonominë e Bujqësisë dhe ushqimit; Certifikatë me nr.2018-28-1-2-1-0091 për Këshilltar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural e lëshuar me datën 11.12.2018 nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Vërtetim me numër protokoli 3319 i datës 16.06.2020, Vërtetim me numër protokoli 3320, i datës 16.06.2020, Vërtetim me numër protokoli 3321 i datës 16.06.2020; Vërtetim i marrëdhënies së punës, i datës 12.09.2022; Letër rekomandimi e datës 13.05.2022 i lëshuar nga Specialistja e Monitorimit dhe Vlerësimit të Projektit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (ARDP); Certifikatë mbi Dënimet Penale me Nr.protokoli 2031CDKEFA.A9492, e datës 27.06.2023 e lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës; Pasqyra e llogarisë së trustit për periudhën 18.04.2005 deri më datë 30.06.2023; Diploma me Nr.99 e datës 02.03.2011 e lëshuar nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë në Universitetin e Prishtinës, Kopja e konkursit me numër reference RN00011694 të datës 18.08.2022; Kopja e konkursit i datës 18.05.2023 për pozitën Inspektor i tokës Bujqësore; Kopja e konkursit me numër reference RN000011981 të datës 29.06.2023; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 13.07.2023; Përgjigje në ankesë e datës 24.07.2023, nga organi i punësimit se bashku me shkresat përcjellëse: Vlerësimet nga Komisioni për vlerësimin në Intervistën me gojë e datës 24.10.2022 për pozitën Zyrtar për bujqësi; Vendimi me Nr.01/1678 i datës 04.10.2022 për themelimin e komisionit të Vlerësimit për konkursin Pranim dhe zhvillimin e procedurave rekrutuese; Njoftimi me Nr.01/1661 i datës 30.09.2022 i lëshuar nga Udhëheqësi i Personelit; certifikate e datës 04.07.2018 për pjesëmarrje në trajnimin për kontrollimin e ushqimit jo shtazorë; certifikatën e datës 31.05.2018 për pjesëmarrje në trajnimin për kontrollimin e ushqimit jo shtazorë; certifikatën e datës 11.12.2018 e lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Letër reference me nr.05-644-2023 e datës 13.09.2022 e lëshuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës; Fletë rekomandim i datës 12.09.2022 nga Drejtori i Zyrës regjistrimit të Popullsisë; Kontratë pune për kohë të caktuar me numër protokoli 4/48 i datës 18.10.2021; Kontratë pune për kohë të caktuar e datës 08.10.2021; Kontratë mbi veprën me Nr.10/20 i datës 01.04.2014 e lëshuar nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim /Komuna e Malishevës dhe vërtetimi me nr.01/276 i datës 07.08.20012.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të administruara, ka konstatuar së ankesa e ankuesit është e pabazuar, SEPSE:

Sipas shkresave të lëndës rjedhë së ankuesi kishte aplikuar në Konkursin për pranim me numër referencë RN000009781, për emrin e grupit Specialistë i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës”, titulli i vendit të punës “ Zyrtar

për Bujqësi”, klasa Profesional 2, i shpallur nga Komuna e Malishevës më datë 18.08.2022, e më ç’rast ankuesi kishte marrë pjesë në të gjitha fazat e vlerësimit, dhe së i njëjti sipas listës përfundimtare të datës 28.10.2023 ishte shpallur si kandidati i dytë i suksesshëm me gjithsej 80.8 pikë.

Me tej, nga provat e lëndës rezultoi se Komuna e Malishevës me datë 18.05.2023 ka shpallur Konkursin për Lëvizje Brenda Kategorisë, më numër reference: RN00011694, për vendin e punës “Inspektor i Tokës Bujqësore”, klasa Profesional 1. Konkursi në fjalë ishte anuluar në fazën e shqyrtimit paraprak për shkak se nuk kishte aplikuar asnjë kandidatë. Ndërsa, më datë 29.06.2023, Komuna e Malishevës për pozitën e njëjtë të punës shpall Konkursin të hapur, me numër referencë RN0001198, për emrin e grupit “Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm”, e në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi më datë 21.07.2023, sipas aplikacionit me numër RNA0016077.

Tutje, Kolegji nga shkresat e kësaj çështje juridiko administrative ka gjetur se me Njoftimin e datës 07.08.2023, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publike pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme ka anuluar konkursin me numër reference RN00011981, mbi bazën së fusha e studimit e kërkuara me kriteret e grupit të administrimit të përgjithshëm dhe fusha e studimit e kërkuara me konkurs janë të pahormonizuara, rrjedhimisht, janë në kundërshtim me Rregulloren Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se Komuna e Malishevës në kundërshtim me dispozita ligjore në fuqi, ka anashkaluar listën pritëse të datës 28.10.2022, lidhur me Konkursin e pranimit, me numër reference: RN000009781, për emrin e grupit Specialistë i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës”, titulli i vendit të punës “Zyrtar për Bujqësi”, rrejdhimisht, e njëjta duke u përpjekur për të anashkaluar këtë listë të pritjes shpall konkurs të jashtëm për pranim për pozitën ” Inspektor i Tokës Bujqësore’, por duke u thirrur në grupin “ Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm” dhe duke u bazuar në kërkesa të njëjta të përgjithshëm formale.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i’u referua dispozitave ligjore në fuqi përkitazi me pranimin në shërbim civil përkatësisht:

Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, neni 34 përcakton se: *“1.Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj, pranimi në Shërbimin Civil bëhet në kategorinë profesionale në grupin e administrimit të përgjithshëm dhe në secilin nga grupet e administrimit të veçantë. 2. Pranimi në kategorinë profesionale bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur dhe publik. Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike dhe sipas nevojave dhe së paku një herë në vit, për grupin e administrimit të përgjithshëm dhe për secilin nga grupet e administrimit të veçantë... 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatët e vlerësuar me 70 për qind apo më shumë, të pikëve totale të vlerësimit, konsiderohen kandidatë fitues dhe renditen nga Komisioni i pranimit, sipas pikëve të marra, në listën e kandidatëve të suksesshëm (në vazhdim: Lista e kandidatëve), e cila publikohet në ueb faqe..”.* Neni 35 përcakton se: *“1. Kandidatët fitues, të përcaktuar sipas paragrafit 9 të nenit 34 të këtij ligji, sipas renditjes, duke filluar nga ai me më shumë pikë, kanë të drejtën të përzgjedhin dhe të emërohen në çdo pozitë të lirë të grupit, për të cilin është zhvilluar procedura e pranimit, si dhe në çdo pozitë tjetër të lirë të të njëjtit grup, që krijohet i lirë gjatë kohës së vlefshmërisë së listës. 2. Njësia e përgjegjëse, brenda 7 ditëve nga shpallja e listës apo nga shfaqja e një pozitë të lirë, organizon procesin e përzgjedhjes të pozitës sipas preferencës nga kandidatët dhe bën emërimin e kandidatit në pozitën e përzgjedhur, sipas paragrafit 1 të këtij neni. Kandidati që ka zgjedhur një pozitë dhe është emëruar në të nuk mund të riuhtrojë të drejtën e përzgjedhjes. 4. Çdo emërim në kundërshtim me këtë nen është i pavlefshëm. 5. Lista e kandidatëve të paemëruar sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, është e vlefshme për një periudhë 1 (një) vjeçare nga shpallja e fituesve. Nëse gjatë kësaj periudhë organizohet një procedure tjetër konkurrimi për të njëjtin grup, kandidatët e listës së mëparshme rirenditen sipas rezultatit të të dyja listave. 6. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratë publike, me akt nënligjor, miraton procedurat e hollësishme për emërimin në kategorinë profesionale”.*

Rregullorja (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil, neni 25 ka paraparë se: *“ 1.Kandidati fitues, sipas renditjes, duke filluar nga ai me më shumë pikë, njoftohet nga njësia përgjegjëse për pozitën e lira dhe ka të drejtën të përzgjedhë çdo pozitë të lirë të Grupit dhe të emërohet në të, për të cilin është*

zhvilluar procedura e pranimit, si dhe në çdo pozitë tjetër të lirë të të njëjtit Grup, që krijohet e lirë deri në një (1) vit nga shpallja publike e listës të kandidatëve fitues. 2.Kandidati që ka përzgjedhur një pozitë dhe është emëruar në të, nuk mund të ushtrojë për herë të dytë, të drejtën e përzgjedhjes sipas paragrafit 1 të këtij neni. 3.Njësia e përgjegjëse, brenda shtatë (7) ditëve nga shpallja e listës apo nga shfaqja e një pozite të lirë të Grupit përkatës, fton kandidatët fitues, sipas renditjes së tyre, të zgjedhin nga lista e pozicioneve të lira. Pëlqimi i kandidatit për të përzgjedhur një vend pune jepet me shkrim... 7.Lista e kandidatëve fitues që nuk janë emëruar, është e vlefshme për një periudhë 1 (një) vjeçare nga shpallja e listës të kandidatëve fitues. Nëse gjatë kësaj periudhë organizohet një procedurë tjetër konkurrimi për të njëjtin Grup, kandidatët e listës së mëparshme rirenditen sipas rezultatit të të dyja listave. 8.Lista e kandidatëve të emëruar dhe lista e kandidatëve të paemëruar mbahen publike sipas nenit 9 të kësaj Rregulloreje.

Në kuptim të dispozitave ligjore si më sipër, e në mbështetje të shkresave të lëndës, Kolegji konstaton së janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit për anashkalim të listës fituese, të datës 28.10.2022, lidhur me Konkursin e pranimit, me numër reference: RN000009781, për emrin e grupit Specialistë i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës-Zyrtar për Bujqësitë, për faktin së ankuesi është përfshirë në listën fituesi lidhur me Konkursin me numër reference RN000009781, për emrin e grupit " Specialistë i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës -Zyrtar Për Bujqësi", klasa Profesional 2", ndërsa Konkursi me numër reference RN00011981 i referohet emrit të grupit " Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm-inspektori i tokës bujqësore, klasa Profesional, 2, pra, kemi të bëjmë me emër të ndryshme të grupeve dhe me tituj të ndryshme të pozitave të punës, andaj, mbi këtë bazë të konstatimit, aplikimi i nenit 35; paragrafi 1, i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk gjen zbatim në rastin konkret, kështu që Kolegji vendosi si në pikën I të dispozitivit.

Përkritazi me Konkursin me numër reference RN00011981, Kolegji nga vlerësimi i shkresave të lëndës ka konstatuar së Komuna e Malishevës ka shpallur konkursin për pranim për pozitën e punës Inspektor i Tokës Bujqësore, në emrin e grupit Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm, ndërsa, si kërkesa të përgjithshme formale janë vendosur: - *Arsimimi i kërkuar*: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve Fakulteti i Bujqësisë. Diplomë e nivelit të pestë të Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK), për profesione deficitare (TIK); - *Përvoja e punës e kërkuar*: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës, e që bazuar në Shtojcën numër 2 të Rregullores (QRK). Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, për emrin e grupit "Specialistë të Administrimit të Përgjithshëm" me Kod të grupit 58, fusha e arsimit është e paspecifikuar, ndërsa në Konkursin me numër reference RN0001198, është specifikuar fusha e arsimit bujqësi, duke qenë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregullore. Rrjedhimisht, në kuptim të dispozitave të nenit 27 të Rregullores (QRK). Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe bazuar në përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e punës Inspektor i Tokës Bujqësore, Kolegji vlerëson së pozita në fjalë ka të bëjë me ushtrimin e përgjegjëseve specifike dhe si e tillë duhet të klasifikohet në grupin përkatës gjegjësisht në emërimin e grupit "Specialist i bujqësisë, pyjeve dhe tokës" sipas Kodit nr.32 të Shtojcës numër 2 të Rregullores (QRK). Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, kështu që nisur nga ky vlerësim kolegji vendosi si në pikën II të dispozitivit.

Referuar nenit 34 të Ligjit Nr.06/L114 për Zyrtarët Publikë, komuna si institucion tjetër shtetëror zhvillon në mënyrë të pavarur procedurën e pranimit në shërbimin civil, dukë nënkuptuar edhe të drejtën e menaxhimit dhe administrimit me tërë procesin rekrutues përfshirë edhe mundësinë e anulimit të një veprimi procedural apo të tërë procesit rekrutues nëse vërehen tejkalime ligjore të cilat procesin/veprimin si të tillë e bëjnë të paligjshme në kuptim të nenit 52 të LPPA-së. Nisur nga ky përcaktim rezulton së Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, është kompetent të organizoj proceset e pranimit vetëm për institucionet shtetërore, përkatësisht DMZP-ja në këtë kontekst mund të ofroj për institucionet tjera shtetërore vetëm udhëzime dhe sqarime për të garantuar zbatimin e unifikuar të legjislacionit për zyrtarët publikë siç është përcaktuar me nenin 11; pika 1.11 dhe 1.14 të Ligjit Nr.06-L-144 për Zyrtarët Publikë. Ndërlidhur më këtë, Kolegji rithekson dhe rikujton faktin së organi i vetëm me kompetencë kushtetuese dhe ligjore për vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve apo mosveprime të institucionet të administratës publike lidhur me procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, ashtu siç është përcaktuar me nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të




Kosovës. Andaj, referuar këtyre konstatimeve, Njoftimi i datës 07.08.2023 i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimi e Zyrtarëve Publikë, lidhur me anulimin e Konkursit me numër reference RN00011981 është nxjerrë nga organi jo kompetent, kështu që, bazuar në nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të LPPA-së, Kolegji vendosi si në pikën III të dispozitivit.

Përmbledhur si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18; paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që ankesa të refuzohet si e pabazuar, të anulohet Konkursi me numër reference RN00011981, për emrin e grupit Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm-Inspektor i Tokës Bujqësisë, i shpallur nga Komuna e Malishevës si dhe çdo veprim i pasuar nga kjo procedurë e pranimit, si dhe të shfuqizohet Njoftimi i datës 07.08.2023 i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë lidhur me anulimin e Konkursit me numër reference RN00011981.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.923/2023

Ardita Percuka Shyti

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Malishevës;
- Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Malishevës;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

